

AKTI I THEMELIMIT

PËR SHOQËRINË "SHAMRAT COMPANY" SHPK

FORMIMI I SHOQËRISË

Sot në Tiranë në datën 25 Janar 2022 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "SHAMRAT COMPANY" shpk, me vullnetin e lirë të ortakëve:

1. Ervin Kastrati, shtetas Kosovar, i biri i Hasan dhe Ruka, i datëlindjes 28.09.1977 lindur në Peje dhe banues në **Tiranë, Rruga Mikel Maruli ,40/10**, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr personl 1003787733.

SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria tregëtare "SHAMRAT COMPANY " SHPK., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e **Tirane, Yzberisht, Rruga Teodor Keko, Zona Kadastrale 3866, Nr Pasurie 215/191- N28**, me vendim të ortakëve të shoqërisë, mund të ngrihen edhe filiale, degë apo dhe seli përfaqësimi në vende të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

1. Shoqëria Tregtare "SHAMRAT COMPANY" SHPK., do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshire edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 000,000 lekë (Dy milion leke), i cili është tërësisht kapital financiar. Kapitali themeltar perbehet vetem nga nje kuote, me vlerë nominale 2 000,000 lekë (Dy milion leke).

Kapitali themeltar zotërohet nga:

1. Ervin Kastrati, zotërues i 1 (një) kuote apo 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të tjetërsojnë, të zmadhojnë apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufinj të përcaktuara nga ligji.

Kapitali fillestar nuk është paguar.



OBJEKTI I VEPRIMTARISË:

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “SHAMRAT COMPANY” shpk do të jetë :

- ✓ Shërbime ndërmjetesimi në shitjen e pasurive të pa luajtshme. Menaxhim dhe qiradhenie pronash. Rekrutim dhe trajnim punonjësish për palet e treta. Ndertime dhe Rikonstruksione objektësh. Instalime në ndërtim dhe të tjera aktivitete të ndryshme të pa përmendura që nuk bien në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Me zgjerimin e aktivitetit shoqëria mund të bëjë shtesa të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj duke bërë ndryshimet përkatëse në statut.

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1. Organi drejtues i shoqërisë është asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështje të mëposhtme :

- a- për ndryshime në statut
- b- emërimin dhe shkarkimin e administratorit
- c- miratimin e bilancit dhe të pasqyrave financiare vjetore.
- d- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- e- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Administratori i përgjithshëm i shoqërisë, është **Ervin Kastrati** me afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

BAZA LIGJORE

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 datë 14.04.2008” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare “ si dhe në legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në tre kopje të barasvlefshme të tij.
Njëri prej tyre ruhet në selinë e shoqërisë.

ORTAKU I VETEM:

Ervin Kastrati

ERVIN KASTRATI

